

LICENCË
Nr.207, datë 12.9.1996

E BANKËS SË SHQIPËRISË DHËNË BANKËS "TIRANA"

Në mbështetje të ligjit nr.8075, datë 22.2.1996 "Për Sistemin Bankar në Republikën e Shqipërisë", nenet 7 dhe 10, të ligjit 8076, datë 22.4.1996 "Për Bankën e Shqipërisë", nenet 6 dhe 13 dhe të vendimit nr.9, datë 30.4.1996 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bankës "Tirana" me drejtori qendrore në Tiranë, me adresë POB 2400/1, i jepet licencë për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë.

Ajo e lejon bankën "Tirana" të kryej veprimtaritë e mëposhtme:

1. Pranimin e depozitave (në formën e depozitave pa afat, depozitave me afat ose formave të tjera të depozitave), për të cilat paguan ose jo interes.
2. Dhënie kredish, duke përfshirë kredi konsumatore dhe hipotekare.
3. Kryerjen e shërbimeve të pagesës.
4. Emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesës (duke përfshirë ndër të tjera pagesat me kartë, me çeket e udhëtarit dhe çeket e bankierit).
5. Ndërmjetësim për operacionet monetare (duke përfshirë valutat).
6. Kryerjen e shërbimeve si agjent financiar ose këshilltare financiare.

Licenca është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme.

Veprimtaria fillon menjëherë.

GOVERNATORI
Kristaq Luniku